

Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më _____.____. 2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik "Kastrati" sh.p.k, NIPT J61813529P, adresë Lagjia 14, Rruga "Tirana", pranë Gjykatës së Apelit, Shkozet, Durrës.

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur, me mjete elektronike.

Numri i referencës së procedurës/lotit: NR. REF - 83047-12-23-2020.

Numri i referencës Loti I: NR.REF - 83053-12-23-2020.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "BLERJE KARBURANTI PËR AUTOMJETET E KESH SH.A ", i ndarë në lote: LOTI I: "BLERJE BENZINE UNL 10PPM PËR AUTOMJETET E KESH SH.A ".

Fondi limit: 24,712,220 (Njëzet e katër milion e shtatëqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind e njëzet) Lekë pa TVSH. LOTI I: "BLERJE BENZINE UNL 10 PPM PËR AUTOMJETET E KESH SH.A ", me fond limit 1,013,004 Lek pa TVSH.

Burimi i financimit: Me të ardhurat e vetë KESH sh.a.

Kontrata do të realizohet në një afat: 12 (dymbëdhjetë) muaj ose me mbarimin e fondit limit.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 126, datë 28.12.2020.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: marzhi më i ulët i fitimit, i shprehur në përqindje.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi 2 (dy) Operatorë Ekonomik, me vlerë të ofertës të shprehur me marzh fitimi :

- 1) OE "A&T" SH.A, NIPT 32320008H, me marzh fitimi 11 %
- 2) OE "KASTRATI" SHPK, NIPT J61813529P, me marzh fitimi 16.4 %

Është skualifikuar OE " A&T" SH.A, pasi nuk plotëson kërkesat për kualifikim si më poshtë:

- 1) Nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e kriterëve të përcaktuara në kapacitetin teknik, pikat Nr 2.2.1, 2.3.1, 2.3.2, 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7
- 2) Nuk ka paraqitur Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.
- 3) Nuk ka paraqitur Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike sipas Shtojcës 6, Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7, Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1, Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas Shtojcës 8.

Është kualifikuar OE "KASTRATI" SHPK, pasi ka paraqitur ofertën konform kërkesave të Dokumentave të Tenderit

* * *

Duke i'u referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik "Kastrati" shpk, NIPT J61813529P me adresë Lagjia 14, Rruga Tirana, pranë Gjykatës së Apelit, Shkozet, Durrës, se oferta e paraqitur me marzh fitimi 16.4% është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor KESH sh.a, në adresë: Rruga "Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 20.01.2021

Ankesa: Jo.

ADMINISTRATORI

BENET BECI